

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Kolegji për të mitur i përbërë nga gjyqtarët Have Haliti, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.H., nga fshati ..., Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeç nga neni 235 par 1 nën par 1.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av. J.B., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për të Mitur, PKR.nr.35/2016, të dt.12.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.05.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E.H., av. J.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për të Mitur, PKR.nr.35/2016, të dt.12.10.2017, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për të Mitur, PKR.nr.35/2016, të dt.12.10.2017, është shpallur fajtor i akuzuari E.H., për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeç nga neni 235 par 1 nën par 1.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, poqë se i akuzuari në afatin e verifikimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara NN, realizimin e kërkesës pasurore-juridike do ta realizojë përmes përfaqësuesit ligjor, në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit E.H., av. J.B., për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet, dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPAM/I.nr.54/2018, të dt.11.05.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit E.H., av. J.B., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E.H., av. J.B., nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë përkundër asaj që ka vërtetuar se e dëmtuara e mitur, në kohën kur ka ndodhur vepra penale ka patur 15 vite e 10 muaj, e cila është vërtetuar në bazë të certifikatës së lindjes, është data 11.11.1998, ndërsa se i akuzuari E.H., ka lindur me dt.02.03.1996, është vërtetuar gjatë zhvillimit të procedurës në këtë çështje penale, andaj, duke llogaritur kohën e kryerjes së veprës penale, e cila është data 10.08.2014, rezulton se i akuzuari ka patur 18 vite e 6 muaj. Nga kjo rrjedh se koha e kryerjes së veprës penale, duhet të jetë dallimi në moshë kur nuk i tejkalon mbi dy vite, kurse në rastin konkret nuk kemi kohën e tejkalar mbi dy vite, ashtu që një veprim i këtillë nuk përbënë vepër penale. Gjykata e shkallës së parë është dashur që ta ketë parasysh nenin 446 par 3 të KPPK, nga i cili rezulton që llogaritja e afateve bëhet me orë, me ditë, muaj dhe vite, andaj, si rezultat i kësaj dispozite ligjore vihet në përfundim se nuk kemi të bëjmë me vepër penale, për çka ka propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet, dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji për të mitur i kësaj gjykate, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale dispozita ligjore përkritazi me veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeç, është aplikuar në mënyrë të drejtë, se nuk ka bazë juridike që i akuzuari të përjashtohet nga ndjekja penale si dhe përgjegjësia penale, s enë mënyrë të drejtë është zbatuar ligji i aplikueshëm i cili ka vlejte në kohën e kryerjes së veprës penale, se gjykata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, se në mënyrë të drejtë janë bërë llogaritjet sa i përket moshës së të miturës-të dëmtuarës, e gjithashtu edhe moshës së të akuzuarit, andaj, në këtë drejtim aktgjykimi nuk ka mangësi, dhe si i tillë është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Përkundër asaj që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar të njëjtin sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin ka aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitën ligjore nga neni 73 të KPK, kur i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se i akuzuari nuk përfshihet në evidencë të të dënuarve, se ka patur sjellje korrekte gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, andaj, në prani të këtyre rrethanave ka aplikuar edhe dispozitën ligjore nga neni 74, 75 dhe 76 të KPK, përkritazi me rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve, zbutjen e dënimeve si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, kurse ka vlerësuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, dhe në prani të këtyre rrethanave ka ardhur

në përfundim se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.219/2018, dt. 28.05.2018**

**Zyrtari Ligjor**  
**Visar Gashi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetare e kolegjit**  
**Have Haliti**

**Afrim Shala**